

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“VINCIALB” sh.p.k

KREU I
HYRJE

Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “VINCIALB” sh.p.k ka ortakët e mëposhtëm:

Valentina Gega, e bija e Niko dhe Leni, e datëlindjes 24.12.1958, lindur në Berat dhe banuese në Fier në adresen Lagjia “ 8 Shkurti”, Rr. “Andon Porro”, Blloku i Bjeshkëve, person madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi 027896678 dhe nr. personal F86224006P;

Antonio Vici, i biri i Michele dhe Gabriella, i datëlindjes 12.02.1975, lindur dhe banues ne Monopoli, Itali në adresen, Rr. “Almeto Pesco”, 18/H (BA) 70043, person madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. AY4651836;

Ortakët, të cilët janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin hartojnë edhe statutin e Shoqerise si më poshtë:

KREU II
PERKUFIZIME


Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emërtimi i shoqerisë është “VINCIALB” sh.p.k..

Neni 3

Asambleja e ortakeve ka vendosur miratimin e statutit te shoqerise ne baze te legjislacionit ne fuqi të Republikës së Shqipërisë, veçanerisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn ne fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Gjithashtu shoqeria e bazon aktivitetin e saj ne ligjin nr. 9121, date 28.7.2003 “Per



Mbrojtjen e Konkurrences" të ndryshuar, ne Kodin Civil dhe Kodin e Punes si dhe ne ligje te tjera ne Republiken e Shqiperise.

Neni 4 Forma

Shoqëria "VINCIALB" sh.p.k është "Shoqëri me Pergjegjësi të kufizuar".

Neni 5 Selia

1. Selia e Shoqerise ndodhet në Qytetin e Tiranës në adresën Rruga " Irfan Tomini", Pll 32, Shk H-1, Ap 6, 3/1G, .
2. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe jashte vendit, ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranës.
3. Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet, mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjeter.


Neni 6 Objekti i veprimtarise se shoqerise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Angjensi turistike, promovimi dhe menaxhimi ;
- Import eksport pijesh (alkolike dhe jo alkolike) dhe produkte ushqimore;
- Ofrim i sherbimit për menaxhim baresh, restorantesh, hotelesh, resortesh;
- Ofrimi i sherbimeve per akomodim ;
- Ofrim i sherbimit per organizim të eventeve;
- Këshillimi financiar;
- Shërbimi i rekrutimit në fushën e turizmit dhe menazhimit i aktiviteteve profesionale që ushtrohen në Republikën e Shqipërisë;
- Trajnimi i stafeve të shoqërive tregtare me objekt promovimin e trurizmit;

Neni 7 Vula e shoqerise

1. Shoqeria ka vulen e saj, ne brendesi te se ciles shkruhet i plote emertimi i shoqerise dhe forma e saj juridike.
2. Te gjitha aktet qe dalin nga shoqeria, pasi nenshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulen e shoqerise.



Neni 8

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

Neni 9

Veprimet e lejuara te shoqerise

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Asambleja e Pergjithshme me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit.

Neni 10

Marredheniet e punes

1. Shoqeria per te kryer veprimtarine e saj sipas objektit te ketij statuti do te lidhe kontrata individuale per te rregulluar marredheniet e punes.
2. Kontratat e punes do te lidhen konform ligjit "Kodi i Punes së Republikës së Shqiperise" i ndryshuar, dhe dispozitave te tjera ligjore qe rregullojne marredheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

KREU III

PARIMI I DETYRIMIT TE BESNIKERISE

Neni 11

Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur

1. Personi i autorizuar per te perfaqesuar shoqerine tregtare nuk mund te lidhe kontrata apo te hyje ne marredhenie te tjera me shoqerine tregtare, nese nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyren e objektin e interesit te tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej te gjithë ortakeve ose te gjithë ortakeve te tjere.
2. Cdo miratim paraprak dhe i pergjithshem njoftohet per regjistrim ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
3. Miratimi i parashikuar jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë:
 - a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/bashkëshortes;

- b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
 - c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
 - d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.
4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum.
 5. Çdo veprim që kërkon miratim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.
 6. Per efekt te ketij statuti, me persona te autorizuar per te perfaqesuar ose mbikqyrur shoqerine tregtare do te kuptojme ortakët e shoqerise, administratorin, ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesin e shoqerise.

Neni12

Parimi i besnikerise

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj ose nga ky statut, në rrethana të njëjta, ortakët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

Neni13

Ndalimi i konkurrences

1. Ortakët apo administratorët e shoqërisë tregtare, me përjashtim të ortakut Antonio Vinci, nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë te punësuar në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
2. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumice te kualifikuar. Për ortakun Antonio Vinci, parashikimi në pikën 1 të këtij neni zëvendëson autorizimin e posaçëm duke qenë se ortaku tjetër Valentina Gega / çdo ortak tjetër që mund të përfshihet në të ardhmen është në dijeni të këtij fakti që në momentin e themelimit të kësaj shoqërie / do të jetë në dijeni të këtij fakti në momentin e përfshirjes në shoqëri.



3. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1, pa përfshirë përjashtimin e bërë, të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
 - a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
 - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
 - c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:
 - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
 - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
 - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KREU IV KAPITALI THEMELTAR - PJESEMARRJA

Neni 14 Kapitali i shoqerise dhe kuotat

1. Kapitali i shoqërisë ka vlerën 100.000 lekë i cili ndahet në 2 kuota.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit të shoqërisë, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njejtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogelohet nën kufirin minimal që lejon ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 15 Kontributet

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë **Valentina Gega** dhe **Antonio Vinci** si vijon:



Ortaku **Valentina Gega** zotëron 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1kuotë, me vlere prej 50.000 lekë

Ortaku **Antonio Vinci** zotëron 50% të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1kuotë, me vlere prej 50.000 lekë;

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

Neni 16

Kalimi i kuotave te kapitalit

1. Kuotat e kapitalit te shoqerise jane të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe te kalueshme ne rruge trashëgimie. Trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi, bëhën ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit te shoqerise mund t'u kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri pasi t'i ofrohet e drejta e parablerjes ortakëve të tjerë të shoqërisë siç është përcaktuar në pikën 3 më poshtë të këtij neni.
3. Ne rast kur njeri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqerise tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë. Kur ortakët qe gezojne te drejten e parablerjes kane dyshime rreth cmimit te kuotave te ortakut qe kerkon ti kaloje ato, mund ti drejtohen gjykates qe te caktojte nje ekspert vleresues. Ortaku qe kerkon kalimin e kuotave tek te tretet duhet te lajmerohet ne nje afat sa me te shpejt, nese brenda 4 javeve ortakut nuk i jepet nje pergjigje atehere prezumohet se ortakët e tjere kane rene dakord qe kuotat e tij mund ti kalohen te treteve.
4. Kalimi i kuotave do te behet me kontrate.
5. Kuotat mund të pjestohen për shkak të kalimit të tyre.

Neni 17

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

KREU V

ORGANET E SHOQERISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE

Neni 18

Asambleja e pergjithshme

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.



2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose nje person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë(perjashtohet perfaqesimi i nje ortaku nga nje ortak tjetër apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkrese, ose nepermjet postes elektronike të deklaruar paraprakisht nga palët.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e meposhtme dhe eshte pergjegjese per to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;
 - d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertëve kontabël te autorizuar;
 - f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
 - h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit(pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
 - i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) Lidhjen e të gjitha kontratave me palë të treta ku shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat;
 - n) Blerjet dhe të gjitha shpenzimet e tjera që kryen shoqëria;
 - o) Strukturën dhe nivelin e pagave të të punësuarve në shoqëri;
 - p) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja përgjithshme vendos me shumice të zakonshme për cështje të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 15 më poshtë të këtij neni. Asamblejamund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave dhe vendimet merren me 2/3 e ortakeve pjesëmarrës.
15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumice të kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme behet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave janë të pranishëm, votojnë me shkresë apo mjete elektronike. Në këto rast vendimet merren me 3/4 e votave të ortakeve pjesëmarrës.
16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këto pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 19 Administrimi


1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

Neni 20

Kompetencat e administratoreve

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Për të gjitha transaksionet në formën e detyrimeve për shoqërinë, duke përfshirë, por pa u kufizuar të gjitha shpenzimet për shkak të blerjeve, marrëdhënieve të punës, investimeve, huave apo formave të tjera me apo pa kontratë të shkruar, administratori do të veprojë me miratim paraprak të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.
3. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme përsa parashikon ky statut ose ligji.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.



Neni 21

Emerimi i pare i administratoreve

Administrator i pare i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet ortaku **Antonio Vinci**.

Neni 22

Eksperte kontabel te autorizuar

1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e pergjithshme me shumice te zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

KREU VI

VOTA

Neni23

E drejta e votes

Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij.

Neni24

E drejta per te kaluar rezolute

Asambleja e pergjithshme mund te miratoje rezolute pa plotesuar kriteret e njoftimit ne kete statut apo ne ligj. Qe te miratohet nje rezolute ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme duhet te jene te pranishem te gjithe ortaket personalisht dhe ta votojne ate ne menyre te unifikuar.

KREU VII

MARREDHENIET FINANCIARE

Neni 25

Viti financiar

Çdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 26

Bilanci vjetor

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e pergjithshme e zakonshme.

2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore bëhet brenda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha qe perdoret ne hartimin e dokumentave vjetore eshte gjuha shqipe.

Neni 27 **Dividentet**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e pergjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin ne raport me kuotat qe gjithsecili ka në shoqëri.

Neni 28 **Marredheniet me bankat dhe institutet financiare**

Shoqëria, pas miratimit paraprak të asamblesë së përgjithshme të saj, ka te drejte te hap llogari likuiduese prane nje ose me shume bankave ose institucioneve financiare dhe te mund te kryeje veprime likuiduese prane bankave. Ne keto banka ose institute financiare si nenshkrim i pare do te depozitohet ai i administratorit te shoqerise, i cili duhet te nenshkruajë per te gjitha veprimet financiare ne emer e per llogari te shoqerise. Ai mund te autorizojë edhe persona te tjere brenda shoqerise.

Neni29 **Marredhenia me organet tatimore**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e te ardhurave, dhe ti depozitojne ato prane organit perkates te tatimeve.

KREU VIII **NDRYSHIMI I STATUSIT TE SHOQERISE**

Neni30 **Prishja e shoqerise**

1. Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhes së parë të ortakut që vdes.

Neni31 **Likuidimi**

1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që ne momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likuidues, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij.



2. Në fund të procesit të likuidimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar të financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.
3. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave të kapitalit tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

Neni 32

Shndërimi i shoqërisë

Shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

KREU IX DISPOZITA TË TJERA

Neni 33

Mosmarreveshjet

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 34

Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky statut nënshkruhet nga themeluesit.

THEMELUESIT E SHOQËRISË

Valentina GEGA

Antonio VINCI

St. 02.10.2019